



Datë: 01.08.2025
Numër Protokollit: 5198/2025

A.nr.1105/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1105/2025, të datës 10.06.2025, të parashtruar nga ankuesja V.Ç, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokati Muharrem Kurtaj, nga Prishtina, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.1105/2025, e datës 10.06.2025, e parashtruar nga ankuesja V.Ç.
- II. **Mbetet në fuqi** Njoftimi me numër:915, i datës 15.05.2025 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.Ç (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), me datë 10.06.2025 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1105/2025, kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00016695 për pozitën Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 18.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 09.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 16.07.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4772/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjën A.nr.1105/2025 të datës 10.06.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3909/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 10.06.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:4772/2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Akt Emërimit e ankueses të datës 31.01.2013; Konkursin e datës 14.02.2025; testin me shkrim të ankueses; E-mailin e datës 20.05.2025 dërguar nga B.H; Testin me shkrim të kandidatit të suksesshëm; Autorizimin e datës 04.06.2025; E-mailin e datës 10.06.2025 dërguar nga ankuesja në Këshill; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.06.2025 dhe 30.07.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 09.07.2025; Listën e kandidatëve në procedurë; Vendimin e datës 01.04.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin e datës 11.04.2025; Njoftimin e datës 29.04.2025; Njoftimin e datës 15.05.2025 për kandidatin e suksesshëm; Aplikacionin e ankueses të datës b13.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomë e datës 20.01.2017; Aplikacionin e kandidatit të suksesshëm të datës 10.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur; Diplomë e datës 13.07.2022; Diplomën e datës 07.05.2015; Diplomë e datës 26.09.2017; Vërtetimin e datës 29.01.2016; Referencë e datës 11.04.2024 lëshuar nga Kompania Liri; Pasqyra e llogarisë së trustit; Certifikatë e datës 07.02.2025.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016695, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve-Profesional 2” Drejtoria e Regjistrimit të Automjeteve/ARC në Prizren, ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.02.2025 deri më 16.03.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Tutje, ankuesja i është nënshtruar testimit me shkrim, ndërsa nga Njësia e Burimeve Njerëzore, është njoftuar se ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 40.6 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullore (QRK) Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: ‘2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.’, ndërsa sipas Njoftimit të datës 15.05.2025 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, pas kryerjes së intervistimit me gojë, rezulton se kandidati që ka marrë pikë të mjaftueshme, është Sh.H me gjithsejtë 80.7 pikë, prej të cilave 52.2 pikë nga testi me shkrim, i cili rezulton të jetë edhe kandidat i suksesshëm në procedurën përkatëse të rekrutimit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshilli, kundër Njoftimit të datës 15.05.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB-së lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se të njëjtës i është bërë e pa drejtë, respektivisht pretendon se vlerësimi i Eses nuk ka qenë objektiv nga ana e Komisionit të Pranimit, pyetja me numër rendor 7 nuk kanë qenë e parashtruar në harmoni me legjislacionin përkatës, nuk është njoftuar nga organi përkatës se e njëjta ka plotësuar kriteret dhe se do ti nënshtrohet testit me shkrim, e njëjta pretendon se lidhur me mbajtjen e testi me shkrim është njoftuar një ditë para mbajtjes së testit me shkrim, testimi me shkrim është mbajtur në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e pranimit në Shërbimin Civil, komisioni i

pranimin nuk ka qenë në përbërje të plotë dhe në harmoni me përgatitjet profesionale, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj ndërsa të detyroi Komisionin e Pranimin të Rishqyrtoi vlerësimin e testit me shkrim apo të anuloi në tersi procedurën e rekrutimit.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, nga analizimi i testit me shkrim të ankueses konstatoi se e njëjta nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 40.6 pikë (prej të cilave 36 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 4.6 pikë nga eseja), ndërsa kandidati i suksesshëm nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 52.2 pikë (prej të cilave 42 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 10.2 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën E Pranimin Në Shërbimin Civil ku përcaktohet: *“Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimin në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit”* si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“6. Testi me shkrim përmban gjithsejtë njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimin, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimin”*, dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimin e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas testit me shkrim të datës 24.04.2025 me kod aplikimi CN4501-ankuesja për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsejtë (4.6) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: *“9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimin në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. **Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.**”* dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankueses nuk janë të bazuara, ngase Komisioni i Pranimin asnjërin nga kandidatët nuk e ka vlerësuar me 20 pikë, aq sa është edhe maksimumi i vlerësimit të eses, respektivisht ankuesen e ka vlerësuar me gjithsejtë 4.6 pikë, kurse kandidatin e suksesshëm Sh.H e ka vlerësuar në ese me 10.2 pikë, ashtu që Kolegji i Këshillit nuk gjeti se në këtë fazë ka pasur shkelje sikurse ankuesja pretendon, për rrjedhje ankuesja nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye e njëjta është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në esenë me shkrim, ngase eseja me shkrim ka qenë: **“Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve në Regjistrimin e Automjeteve: Një qasje për më shumë efikasitet”**, ndërsa ankuesja është përgjigjur si në vijim: *“do të bashkëpunoj së pari me kolegët e punës me koordinatoren e QRA-së dhe me të gjitha QRA-at nëse kanë nevojë nëse na paraqitet ndonjë problem ose ndonjë kërkesë për transferimin e dokumenteve në qendra tjera bashkëpunojmë ngushtë me koordinatoren në zgjedhjen e problemeve që na paraqiten në qendër tonë gjithmonë në të mirën e qytetarëve. Do të punojë me përgjegjësi të plotë dhe për çdo paqartësi do të konsultohem me kolegët e punës dhe koordinatoren. Do të kem një qasje të mirë me palët dhe çdoherë kur ata kanë nevojë për*

punën time asnjëherë nuk kursehem”, sikurse edhe pretendimi ankimor se pyetja numër 7 shtatë nuk ka qenë në harmoni me legjislacionin përkatës nuk është i bazuar, ngase Njësia e Burimeve Njerëzore ka dhënë sqarimet e saja dhe është konstatuar fakti se pyetja përkatëse (**pyetja 7: Çfarë ndodhë nëse një automjet ç’lajmrohet për eksport**) ka qenë e parashtruara sikurse përcaktohet apo rregullohet çështja përkatëse me nenin 20 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.04/2023 për Regjistrimin e Mjeteve, ndërsa përgjigja e ankueses ka qenë si në vijim: “ *Automjetet nuk mund të regjistrohen jashtë vendit pa një vendbanim nga MBP*”, përgjigje kjo e pasaktë referuar udhëzimit administrativ përkatës të cekur si më lartë.

Kolegji i Këshillit po ashtu nga analizimi i shkresave të lëndës konstatoi se, Sekretarja e Përgjithshme e MPB-së, lidhur me procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016695, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, për pozitën “*Zyrtar për Regjistrimin e Automjeteve*”, e ka themeluar komisionin ad hoc të pranimit sipas Vendimit Nr.553/2025 të datës 04.04.2025, me përbërjen si në vijim: A.A-Koordinatorë në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Mitrovicë-kryesuese (Akt Emërimi i datës 22.11.2013); F.L-Udhëheqës i Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve në Zubin Potok-anëtarë (Akt Emërimi i datës 01.07.2024); E.A- Udhëheqës i Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve në Zveçan-anëtar (Akt Emërimi im datës 01.08.2024); B.Sh-Zyrtarë e Lartë e Personelit në MPB-anëtarë (Akt Emërimi i datës 14.01.2013) dhe A.B-Nëpunës Administrativ në QRA Obiliq-anëtarë (Akt i Emërimit i datës 23.05.2013), sikurse që të gjithë anëtarët kanë pasur të caktuar edhe zëvendësues, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses nuk është i bazuara pasi që Komisioni përkatës i pranimit është themeluar sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L197 për Zyrtarët Publik, “*1. Vlerësimi profesional i kandidatëve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*”.

Kolegji i Këshillit, po ashtu konstatoi se Njësia e Burimeve Njerëzore e MPB-së, lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit, me datë 01.04.2025 ka nxjerrë Vendimin Nr.536 përmes të cilit ia ka vazhduar afatin vendimmarrës fazës së verifikimit paraprake për 15 ditë, ashtu që vendimin në fjalë e ka mbështetur në dispozitat e nenit 99 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “*1. Përveç kur ndalohe shprehimisht me ligji, nëse është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete, organi publik mund të shtyjë, vetëm një herë, afatin fillestar të paraparë për përfundimin e procedurës administrative, sipas nenit 98 të këtij Ligji. 2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjestim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar.*”, ndërsa me datë 11.04.2025 Njësia e Burimeve Njerëzore e ka lëshuar Njoftimin përmes të cilit ka bërë njoftimin se cilat kandidatë në procedurë e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa sipas shkresave të lëndës testi me shkrim është mbajtur me datë 24.04.2025 fakt ky i dëshmuar edhe përmes testit të ankueses më kod CN4501, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses se testi me shkrim është mbajtur jashtë afatit të caktuar prej 15 ditës pas publikimit të listës së ngushtë të kandidatëve nuk është i saktë, gjegjësisht testi me shkrim është mbajtur në ditën e 13 pas publikimit të Njoftimit për fazën e verifikimit paraprak , veprim ky në përputhje me nenin 9 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “*1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak.*”

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me RN00016695, për Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, pozita “Zyrtar për Regjistrim e Automjeteve”-Prizren ka konstatuar së për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **“Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në: Arsim i lartë i paspecifikuar; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.”**

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit mori për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës 1 të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës 6 të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua fakti se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 21.01.2025.

Duke marrë për bazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimin Nr.02/226 e të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita *Zyrtar për Regjistrim e Automjeteve*, klasa Profesional 2, identifikohet me kodin SHC-1401 në kuadër të grupimit **Grupi i Administrimit të Përgjithshëm**, kurse fusha e kërkuara e arsimit përcaktohet të jetë: **Arsim i lartë i paspecifikuar**, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se konkursi në fjalë me shifër RN00016695 i datës 14.02.2025 është shpallur në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara nga neni nenit 19, si dhe neni 30 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: **“19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.”**

Me qëllim të konstatimit të faktit nëse kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit, Kolegji i Këshillit analizoi aplikacionin e kandidatit të suksesshëm të datës 10.03.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur dhe gjeti se i njëjti posedon Diplomën e datës 07.05.2015 me numër:25 të lëshuar nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti ka mbaruar studimet në fakultetin Juridik me datë 26.11.2014 dhe ka fituar gradën Bachelor, po ashtu posedon Diplomën e datës 07.05.2015 me numër:25 të lëshuar nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti ka mbaruar studimet në Fakultetin Juridik me datë 26.11.2014 dhe ka fituar gradën Bachelor, kurse lidhur me përvojën e punës posedon Vërtetimin Nr.165/2016 të datës 29.01.2016 lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, përmes së cilës dëshmohet fakti se i njëjti ka kryer punën praktike nga data 30.01.2015 e deri me datë 29.01.2016 në kohëzgjatje prej një (1) viti në zyrën e Avokatit Hylki Kurtaj në Prizren, po ashtu Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi me rastin e aplikimit kishte ofruara edhe dëshmi të tjera si diploma dhe përvojë të punës, mirëpo nuk u lëshua në shqyrtim të mëtejme pasi që konstatoi se kandidati në fjalë i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit të datës 14.02.2025 me shifër RN00016695 duke iu referuar konstatimeve të dhëna si më lartë për kualifikimin arsimor dhe përvojën e punës, respektivisht me rastin e përfshirjes së tij në listën e ngushtë Komisioni i Pranimit ka vepruar në pajtueshmëri me

nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht procedura e rekrutimit për pozitën përkatëse është zhvilluar në pajtim me dispozitat e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara ligjore të ligjit material, dhe konstatimit si më lartë se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara, Kolegji i Këshillit vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu që refuzoi ankesën e ankueses, ndërsa la në fuqi aktin e kontestuar pasi që i njëjti është nxjerrë duke u bazuar në ligjin material dhe dispozitat e aplikuara nga nenin 47 dhe 48 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1105/2025, datë 01/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokatit Muharrem Kurtaj;
- Ministria e Punëve të Brendshme (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.